



AKTI I THEMELIMIT

TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT" SHPK

Neni 1

Une ortakut i vetem Behar Male i biri i Skenderit dhe i Sulltanës i datelindjes 1964. lindur ne Permet e banues ne Tirane, rruga Mihal Grameno, pall.32/1, ap.14, sot me daten 1.12.1998 me vullnetin tim te lire e te plote krijova shoqerine me pergjegjesi te kufizuar te emertuar "TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT" shpk.

Neni 2


Selia e shoqerise do te jete ne Tirane, rruga Mihal Grameno, pall.32/1, ap.14. Me vendim te ortakut te vetem mund te hapen agjensi, filiale, dege apo forma te tjera shoqerish brenda dhe jashte teritorit te Shqiperise.

Neni 3

Kohezgjatja e shoqerise do te jete 10 vjet dhe do te filloje nga momenti i regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar te gjykates Tirane me perjashtim te rasteve kur mbaron sipas parashikimeve ne ligj ose kur vendos ortakut i vetem

Neni 4

Shoqeria ka si objekt te veprimtarise se saj: Import -eksport, riekспортim, tranzitim, tregtim te te gjitha mallrave te ndryshme me shumice dhe pakice, produkte me origjine bujqesore, blegtorale, mallra te ndryshme ushqimore te gatshme e gjysme te gatshme, materiale ndertimi te llojeve te ndryshme, pajisje elektro-kulturore dhe elektroshtepiake, pajisje hidrosanitare, pije alkolike dhe joalkolike, duhan e cigare si dhe mallra te tjera te lejuara nga normat shtetore. Marrje persiper e hartimit te projekteve te ndryshme ndertimore te fushave te ndryshme dhe te realizimit te anes ndertimore te tyre. *Investime ne fushen e turizmit, infrastruktures,* konvertim te valutave,



Neni 5

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke i formuar ne mase te plote nga kontributi i ortakut te vetem Behar Male.

Neni 6

Per nevoja te punes dhe te ushtrimit te aktivitetit te saj shoqeria mund te çele llogari ne çdo banke te njohur me ligj, qofte kjo private ose shtetore.

Neni 7

Per nevoja te punes kjo shoqeri mund te punesoje edhe puntore e specialiste te ndryshem me kontrate te rregullt pune sipas ligjeve ne fuqi.

Neni 8

Administrator i shoqerise eshte Behar Male i Skenderit dhe i Sulltanes i datelindjes 1964, banuese ne Tirane, rruga Mihal Grameno, pall.32/1, ap.14

Neni 9

Shoqeria do te rregullohet pervec ketij akti edhe me norma te percaktuara ne statutin e saj. Akti i themelimit u perpilua ne 4 kopje per tu administruar sipas ligjit.

ORTAKU I VETEM

Behar Male

REPUBLIKA E SHQIPERISE


NOTERIA

Nr. 2722 rep

Nr. 590 kol

VERTETIM

Sot me daten 12.03.1998, para meje noteres u paraqit personalisht Behar Male, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cilit u sigurova nga leter njoftimi i cili deklaroi sa me siper eshte shkruar sipas vullnetit te tij te lire dhe te plote e nenshkroi para meje dhe une noterja e vertetoj firmen sipas ligjit.





STATUTI

SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT" SH.P.K

FORMA, BAZA JURIDIKE, SELIA

Neni 1

Une ortaku i vetem Behar Male me daten 1.12.1998 kam krijuar shoqerine me pergjegjesi te kufizuar e emertuar "TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT " sh.p.k.

Neni 2

Shoqeria eshte formuar sipas legjislacionit shqiptar dhe si person juridik fillon me regjistrimin e saj ne regjistrin tregtar te gjykates se rrethit Tirane.

Neni 3

Shoqeria e ka seline ne Tirane, rruga Mihal Grameno, pall.32/1, ap.14 . Shoqeria mund te ndryshoj seline e saj me miratim te ortakut te vetem. Ajo mund te hapi dege, filiale dhe agjensi ne te gjithe teritorin e Shqiperise sipas vendimit qe do te marre ortaku i vetem.

Neni 4

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me statutin e saj ne teritorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte tij.

FUSHA E AUTORITETIT TE ORTAKUT

Neni 5

Fusha e autoritetit te ortakut, perqindja e fitimeve ose e humbjeve do te kete si kriter baze kapitalin e shoqerise si dhe kompetencat qe gezon ne marrjen e vendimeve te çdo karakteri te percaktuara ne kete statut.

LIBRI I SHOQERISE

Neni 6

Per te saktësuar veprimtarine e vet ekonomike si dhe mardheniet e punes ,shoqeria do te kete librin e vet i cili do te quhet libri i shoqerise.

KONFIDENCIALITETI

Neni 7

Ortaku i vetem si dhe personat e tjere te pranuar ne shoqeri bien dakort qe te mos i ekspozojne asnje personi te jashtem informacionet qe disponon shoqeria kontratat qe do te lidh si dhe planet ose qellimet qe ka per te ardhmen.

Neni 8

Te gjitha aktet dhe dokumentat qe nxirren nga shoqeria te destinuara per te tretet si letrat faturat lajmerimet dhe publikimet e ndryshme duhet te tregojne lexueshem emrin e shoqerise.

OBJEKTI

Neni 9

Shoqeria ka si objekt te veprimtarise se saj: Import -eksport, rieksporim, tranzitim, tregtim te te gjitha mallrave te ndryshme me shumice dhe pakice, produkte me origjine bujqesore, blegtorale, mallra te ndryshme ushqimore te gatshme e gjysme te gatshme, materiale ndertimi te llojeve te ndryshme, pajisje elektro-kulturore dhe





elektroshtepiake, pajisje hidrosanitare, pije alkolike dhe joalkolike, duhan e cigare si dhe mallra te tjera te lejuara nga normat shtetrorre. Marrje persiper e hartimit te projekteve te ndryshme ndertimore te fushave te ndryshme dhe te realizimit te anes ndertimore te tyre. Investime ne fushen e turizmit infrastruktures, , konvertim te valutave,

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Neni 10

Shoqeria do te zhvilloj aktivitetin e saj 10 vjet, duke filluar nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar te gjykates se rrethit Tirane, me perjashtim te rastit te mbarimit te afatit sipas kushteve te parashikuara ne ligj ose me vendim te ortakut te vetem.

KAPITALI THEMELTAR

Neni 11

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke. Shoqeria mund te shtojë kapitalin e saj sipas vendimit te ortakut te vetem.

KONTRIBUTET

Neni 12

Kapitali themeltar i shoqerise eshte i perbere ne mase te plote nga kontributi i ortakut te vetem Behar Male.

LENIA DHE TRANSFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT

Neni 13

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme tek personat e trete ne qofte se vendos per kete ortaku i vetem Behar Male. Gjitheashtu ato jane lirisht te



transferueshme ne rruge trashgimie. Sipas vendimit te ortakut te vetem ato mund te transferohen edhe jashte shtetit.

Transferimet e pjeseve te kapitalit themeltar duhet te vertetohen me nje akt noterial.

STRUKTURA JURIDIKE DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Neni 14

Shoqeria do ta konsideroj qendren e vet si shoqeria nene e cila rast pas rasti do te hapet me ane dege, filiali, agjensi ne te gjitha ato vende ku do te shikoj interes ne permbushjen e qellimit te saj ne te gjithë teritorin e Republikes se Shqiperise ose jashte tij.

Neni 15

Organet e shoqerise jane si me poshte:

1. Vendimet e ortakut te vetem,
2. Administratori,
3. Komisioni i eksperteve kontabel. Detyrat e komisionit te eksperteve kontabel caktohen ne perputhje me ligjin per kontabilitetin.

ADMINISTRATORI

Neni 16

Administratore i shoqerise eshte Behar Male i biri i Skenderit i datelindjes 1964, banuese ne Tirane, rruga Mihal Grameno, pall.32/1, ap.14 i cili eshte pergjegjes ndaj te treteve per shkelje ligjore, per shkelje te statutit ose per gabime e faje te kryera gjate administrimit.

LIBRAT E SHOQERISE, BILANCI, SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI

Neni 17

Shoqeria eshte e detyruar te mbaje dokumentacionin kontabel. Librin e shoqerise ne te cilin shenohen emri i plote i ortakut, kapitali themeltar si dhe vendimet qe merr ortakut.



Neni 18

Bilanci financiar mbyllet ne 31 dhjetor te çdo viti. Llogarite vjetore, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabel miratohen nga ortakut i vetem.

Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

Neni 19

Ortakut i vetem nepermjet vendimeve qe merr realizon te gjitha veprimtarine e shoqerise. Ai percakton drejtimet kryesore, vendos per bilancin vjetor, per ndryshimet ne statut, ne aktin e themelimit, per shtimin ose pakesimin e kapitalit, per pranimin ne shoqeri te ortakeve te tjere, te gjitha keto ne zbatim te ligjit per shoqerite tregtare.

Neni 20

Ortakut i vetem lidh kontrata me persona fizik e juridik shtetror ose privat, vendas e te huaj si dhe vendos vet per drejtimet e aktivitetit te shoqerise. Ai vendos per fuqine puntore, per pagat e tyre duke lidhur kontrata me ta sipas marreveshjes se dyanshme, ne perputhje me ligjet shqiptare.

Neni 21

Administratori ka te drejte te emeroj ekonomist dhe avokat si dhe tu jap te drejte personave te trete qe te veprojne ne emer e per llogari te tij me autorizim apo me prokure, ne pershtatje e ne perputhje te plote me ligjin shqiptar.

Neni 22

Shperndarja e shoqerise mund te behet ne çdo kohe dhe per çfaredo shkakut, si humbje e kapitalit te shoqerise, pamundesi veprimi ose me vendim te ortakut te vetem. Per kete administratori vendos per menyren e likuidimit te saj. Caktohet nje ose disa likuidatore. Keta bejne kujdes qe shoqeria te likujdoje me pare detyrimet qe ajo u ka personave fizik e juridik.



Neni 23

Shoqeria ka vulen e saj me permbajtje "TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT " SH.P.K. Tirane, Albania.

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 24

Persa nuk eshte shkruar ne kete statut i referohet plotesimeve nga vendimet e ortakut te vetem si dhe ligjeve perkatese shqiptare per shoqerite tregtare.

Neni 25

Te gjitha mosmarreshjet qe mund te lindin gjate ekzistences se shoqerise ose gjate periudhes se likuidimit do ti paraqiten per zgjidhje gjykates kompetente.

Neni 26

Ky statut eshte hartuar ne 4 kopje per tu administruar sipas ligjit.

ORTAKU I VETEM
BEHAR MALE

REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA

Nr. 248 rep

Nr. 591 kol

VERTETIM

Sot me daten 3.12.1998, para meje noteres u paraqit personalisht Behar Male madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cilit u sigurova nga leter njoftimi i cili deklaroi sa me siper eshte shkruar sipas vullnetit te tij te lire dhe te plote e nenshkroi para meje dhe une noterja e vertetoi firmen sipas ligjit.

